



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 27.12.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3733/17, për zyrtarin e lartë z. Labinot Tahiri, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-3733/17, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Labinot Tahiri, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit, është vërejtur se zyrtari i lartë z. Labinot Tahiri, figuron si person i autorizuar në bizneset private me emër "ICON#S" Sh.p.k, dhe N.SH.P "Erzana" e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Tahiri, në përmes personit të autorizuar ka kontaktuar me zyrtarët e AKK-së, dhe ka shprehë interes për tu njoftuar për situatën që është duke u trajtuar z. Labinot Tahiri.

Zyrtarët e AKK-së, një ditë pas kësaj kanë takuar personin e autorizuar të zyrtarit të lartë z. Labinot Tahiri, dhe me autorizimin e tij e kanë njoftuar për procedurat, ndërsa i njëjti ka komunikuar me zyrtarin e lartë pasi që ka qenë jashtë vendit duke na njoftuar se zyrtari i lartë



nuk ka qen në dijëni për çështjen e ngritur nga AKK-ë, por ka deklaruar se do të veproj menjëherë sipas ligjit në fuqi për ta parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit duke sjell dëshmi se nuk do të figuroj si person i autorizuar në këto biznese.

Pas këtyre veprimeve nga z.Labinot Tahiri, kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se zyrtari i lartë z.Labinot Tahiri, nuk figuron me si person i autorizuar ne bizneset private me emër "ICON#S"Sh.p.k dhe N.SH.P "Erzana"

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga z.Labinot Tahiri, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke bërë ndryshimet ne biznes, duke hequr dorë nga përgjegjësit dhe të drejtat e funksionit si personi i autorizuar ne bizneset private janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

